

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MARKU GROUP” SH.P.K.

Sot, më datë 01.04.2023

Z.Sajmir MARKU, i datelindjes 24/04/1991, lindur ne Laç dhe banues ne Kruje, me zatesi te pote per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti me ID 033680050 dhe Nr.personal J104240190

Kane perpiluar këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare “**MARKU GROUP**” SH.P.K., me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare “**MARKU GROUP**” SH.P.K., themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shaqeritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**MARKU GROUP**” SH.P.K. Ajo do te ketë edhe vulen e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:

- Prodhime, saldime, Konstruksione metalike. Prodhim, zbatim dhe montimi rikonstrukSIONEVE te godinave industriale dhe civile, urave, Hec-eve, ujesjellesa, gazu-sjellesa, me konstruksione metalike, mbikalime per kalimtare dhe hekurudhere, tunele, sillosa metalike, kulla uji metalike, depozita metalike, cisterna metalike, tubacione metalike etj.
- Aktivitet ne fushen e ndertimit, dhe rikonstrukSionit te objekteve civile, industriale, turistike, shendetore, kulturore, tregtare, sportive, vepra kullimi, ujesjellsave, rrugë, kanalizime, punime infrastrukture, porte, asistencë dhe ekspertizë teknike, etj. Realizimi, instalimi i impianteve hidrike, ujesjellesave, impianteve klimatike.
- Punime hekuri dhe hidraulike, Punime betoni dhe betonarmeje, germime dhei, Punime shtresash ne rruge, Punime asfaltimi.
- Tregtim, Import-eksport te mallrave te ndryshme industriale, tuba, rekorderi per ujesjellesa, materialeve te ndertimit, konstrukSIONEVE metalike, etj.
- Transport te udhetareve e mallrash brenda dhe jashte vendit per vete dhe per te trete e me qira.
- Për realizimin e qellimit te saj shoqëria mund te bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik ne çdo mënyrë qe e gjykon te dobishme.
- Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë cdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Shoqëria ka seline ligjore:

Durres, Kruje, Thumane,Derven, Zona Kadastrale 1475, Godine me nr. Pasurie 136/18

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë dhe përbehet nga 1 (një) kuote.

1) Z.Sajmir Marku eshte zoterues i 1 kuote me 100% pjesemarje ne kapitalin e shoqerise ne vleren 100.000 leke.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Afat i kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakeve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjeçar, me te drejte riemërimi. Administratori i Shoqërisë do të jetë **Z. Sajmir MARKU**

Shoqeria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marredhëniet me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesemarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijoje çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me pérjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në perputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 10

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punëshuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdmtojnë Shoqerinë për dëmet që i janë shkaktuar përfaj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.


NENI 11

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqërisë. Cdo gjë që nuk ështe parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore ne fuqi.

ORTAKU THEMELUES

Sajmir MARKU

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Sajmir Marku". Below the main name, there is a smaller, stylized signature or initial "SM".